



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Datë 15/11/2024

PROCES VERBAL

Konsultimi për Buxhetin dhe Paketën Fiskale 2025

Vendi : Njësia Administrative Piskovë

Ora : 11:00

Tema e konsultimit : Buxheti dhe Paketa Fiskale 2025.

I mbajtur sot më datë 15 Nëntor në ambientet e Njesisë Administrative Piskovë me pjesëmarrjen e Kryetares së Bashkisë, znj.Alma Hoxha, nën/Kryetarit z.Florand Hasani, Kryetarit të Komisionit të Ekonomisë z.Agathokli Proko.

Pjesëmarrës janë Kryetarët e Fshatrave të Njesisë Administrative Piskovë dhe banorë të zonës.Takimin e hapi znj.Alma Hoxha e cila falenderoi të gjithë të pranishmit qe marrin pjese dhe jane zeri i komunitetit te fshatrave ku banojne. Në vijim të fjalës së saj ajo u tha se këto takime janë mjaft të rëndësishme për të hartuar buxhetin e ri dhe për tu njohur më shumë me problematikat e zonave përreth. Më pas Kryetarja u tregoi të pranishmëve se investimet e reja dhe shërbimet do të jenë në fokusin e saj për vitin e ardhshëm. Gjithashtu ajo u tregoi se janë bërë mjaft investime në kanalet vaditëse të fshatrave si dhe theksoi se prioritet mbetet Ujësjiellësi i Rapçkës. Pas fjalës së Kryetares rradhën e morën të pranishmit të cilët paraqitën problematikat si më poshtë :

Fshati Hotovë

1. Rruga e fshatit ka nevojë për pastrim

Fshati Raban

1. Probleme me rrugën që të çon në fshat
2. Nevojë për ndërhyrje te rrethimi i varrezave
3. Problematikë lidhur me koshat e mbetjeve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Fshati Kutal

1. Rruga e varrezave dhe hyrja e saj nevojë për ndërhyrje
2. Probleme me ujin e vaditjes së tokave

Fshati Rapckë

1. Vendosja e një koshi për mbeturina tek stacioni i autobusit

Fshati Kosinë

1. Vendosja e një portë të re në hryje të varrezave

Në fund të këtij takimi znj. Alma Hoxha u tha banorëve se shumë shpejt vendgrumbullimi aktual i mbetjeve në fshatin Piskovë do të mbyllet për tu transferuar diku tjetër. Duke i falenderuar edhe një herë për bashkëpunimin e mirë që ekziston, znj. Alma Hoxha u shpreh se do të shohin të gjitha mundësitë për të reflektuar zerin e tyre në zërat buxhetore për vitin 2025 si dhe të gatshme për të folur me banorët në lidhje me problematikat e tyre sa herë ata ta shohin të nevojshme jo vetëm me Bashkinë por edhe në Këshillin Bashkiak.

Konceptoi:

Koordinatori i Konsultimit Publik

Albion Naska

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Denisa DURO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Foto nga takimi:

